



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT
TË TERRITORIT

Nr. 3997 prot.

Tiranë 27/1 /2025

Lënda: Kthim përgjigje

QENDRA "RES PUBLICA"

Adresa: Blv "Gjergj Fishta", dërtesa 24, Hyrja 3. Ap.7

Në përgjigje të kërkesë tuaj protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. prot. 49652, datë 30.12.2024, me anë të cilës kërkon vënien në dipozicion të Vendimit nr. E-17184/2, datë 27.11.2024 e kryetarit të Bashkisë Tiranë për miratimin e lejes së ndërtimit për "Rikonstruksion i pallatit ekzistues 5 kate (Nr. 116), të dëmtuar si pasojë e fatkeqësive natyrore, pa shtim apo ndryshim vëllimi", në rrugën "Muhamet Gjolllesha", Njësia Administrative nr. 7, Tiranë, më subjekt zhvillues Bashkinë Tiranë dhe subjekte ndërtuese bashkimi i operatorëve "PEPA GROUP" sh.p.k, "JUNIK" sh.p.k. dhe "Nika" sh.p.k.

Bashkëlidhur gjeni Vendimin nr. E-17184/2, datë 27.11.2024 e kryetarit të Bashkisë Tiranë

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



BASHKIA TIRANË

V E N D I M

Nr. E-17184/2

PËR

Miratimin e lejes së ndërtimit për "Rikonstruksion i pallatit ekzistues 5 kate (Nr. 116), të dëmtuar si pasojë e fatkeqësive natyrore, pa shtim apo ndryshim vëllimi", në rrugën "Muhamet Gjollesha", Njësia Administrative nr. 7, Tiranë, më subjekt zhvillues Bashkinë Tiranë dhe subjekte ndërtuese bashkimi i operatorëve "PEPA GROUP" sh.p.k, "JUNIK" sh.p.k. dhe "Nika" sh.p.k.

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b"; nenin 23, pika 14; nenin 64 shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar); Nenin 24 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar); Ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile"; Aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", (i ndryshuar); Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore" (i ndryshuar); Urdhëresën e Kryetarit të Bashkisë nr. 8741, datë 21.03.2016 "Për procedurën e shqyrtimit të aplikimeve të lejes së zhvillimit/ndërtimit, deklarata paraprake për kryerje punimesh, çertifikatë përdorimi, gen-plane azhurnimi dhe përditësimet e infrastrukturave të tjera" (e ndryshuar); Urdhërin nr. 11987, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë "Për ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë" (i ndryshuar); Manualin e Procedurave dhe Organizimit të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim nr. 11987/1, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë (i ndryshuar); si dhe mbështetur në opinionin e datës 20.11.2024 të Këshillit Teknik, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së dorëzuar elektronikisht me numër aplikimi AN231020240036 dhe protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr. prot. E-17184, datë 23.10.2024, për leje ndërtimi për "Rikonstruksion i pallatit ekzistues 5 kate (Nr. 116), të dëmtuar si pasojë e fatkeqësive natyrore, pa shtim apo ndryshim vëllimi", në rrugën "Muhamet Gjollesha", Njësia Administrative nr. 7, Tiranë, më subjekt zhvillues Bashkinë Tiranë dhe subjekte ndërtuese bashkimi i operatorëve "PEPA GROUP" sh.p.k, "JUNIK" sh.p.k. dhe "Nika" sh.p.k.

V E N D O S A :

1. Të miratoj leje ndërtimi për "Rikonstruksion i pallatit ekzistues 5 kate (Nr. 116), të dëmtuar si pasojë e fatkeqësive natyrore, pa shtim apo ndryshim vëllimi", në rrugën "Muhamet Gjollesha", Njësia Administrative nr. 7, Tiranë, më subjekt zhvillues Bashkinë Tiranë dhe subjekte ndërtuese bashkimi i operatorëve "PEPA GROUP" sh.p.k, "JUNIK" sh.p.k. dhe "Nika" sh.p.k, sipas projektit të hartuar nga projektues të licensuar, ngarkuar në sistem;

2. Afati i lejes së ndërtimit është 12 muaj. Ky afat fillon nga data e fillimit të punimeve të ndërtimit;
3. Bazuar në nenin 25, 36 të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; në nenin 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar) *rindërtimi dhe rikonstruksioni i banesave përjashtohet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifa e aplikimit të zbatueshme për lejet e ndërtimit*;
4. Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit, të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen probleme në rrjetin publik;
5. Pas përfundimit të punimeve të kthehet territori rrethues në gjendjen e mëparshme, të riparohen të gjitha dëmtimet në rrugë, trotuare, etj;
6. Të mos bëhen ndryshime nga projekti i hartuar nga projektues të licensuar, i ngarkuar në sistem, pa miratimin paraprak nga Bashkia e Tiranës, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi;
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erion
Veliaj
ERION VELIAJ

Digitally signed by
Erion Veliaj
Date: 2024.11.27
21:02:04 +02'00'

Drejtor i Përgjithshëm DPPZHT: Anisa Lila
Drejtor i DLZHT: Dition Shkurtaj
Drejtor i DMT: Donald Mustafaraj
Përgjegjëse ST(e deleguar): Diana Prifti
Specialist jurist SLZH: Isan Goxhi
Specialist ST: Matilda Sotiri

Anisa
Lila

Digitally signed by
Anisa Lila
Date: 2024.11.27
16:29:54 +02'00'

Dition
Shkurtaj

Digitally signed by
Dition Shkurtaj
Date: 2024.11.27
16:29:54 +02'00'

Donald
Mustafaraj

Digitally signed by
Donald Mustafaraj
Date: 2024.11.27
16:29:54 +02'00'

Diana
Prifti

Digitally signed by
Diana Prifti
Date: 2024.11.27
16:29:54 +02'00'

Isan
Goxhi

Digitally signed by
Isan Goxhi
Date: 2024.11.27
16:29:54 +02'00'

Matilda
Sotiri

Digitally signed by
Matilda Sotiri
Date: 2024.11.27
16:29:54 +02'00'